79

ISSN 2309 3455

Social Studies

Studime Sociale

Vol. 20, No. 5 (79), 2026

Jorida RUSTEMI • Erion KRISTO • Valbona BANKA
• Ananda RAO KURITI • Blendi LAMI • Ervin HOXHAJ
• Erion SHEHU • Gjovalin GJELOSHI
• Luana HARIZAJ • Erjona FUSHA • Simon LUFI
• Marsel NILAJ • Blerina KARAGJOZI • Zana STRAZIMIRI
• Genita HOXHA • Migena KAPLLANAJ
• Bernard ZENELI

www.sociology.al

ALBSA-SHSSH
Albanian Sociological Association
Shoqata Sociologjike Shqiptare

AIS
Albanian Institute of Sociology

“Social Studies” Journal is classified ‘Scientific’ by ANVUR

The journal “Social Studies” is classified as Scientific Journal by ANVUR, the National Agency for the Evaluation of the University System and Scientific Research of Italy - Ministry of Education, Universities and Scientific Research of Italy (MIUR), by decision no. 298, dated 21 December 2021.

The application was made in 2020 by Romina GURASHI (PhD) - from “Sapienza” University of Rome, Deputy Editor of the journal “Social Studies”.

Since 2020, ANVUR has monitored the journal “Social Studies” with international experts, and the official response has been returned by Dott. Marco Malgarini, director of ANVUR, on 19 January 2022.

La rivista “Studi Sociali”
è classificata ‘Scientifica’ dall’ANVUR

La rivista “Social Studies” è classificata ‘scientifica’ dall’ANVUR, Agenzia Nazionale per la Valutazione del Sistema Universitario e della Ricerca Scientifica d’Italia - Ministero dell’Istruzione, dell’Università e della Ricerca Scientifica d’Italia (MIUR), con decisione n. 298, del 21 dicembre 2021.

La richiesta è stata presentata nel anno 2020 da Romina GURASHI (PhD), dell’Università La Sapienza, Vicedirettore della rivista “Studi Sociali”.

Dal 2020 ANVUR segue con esperti internazionali la rivista “Social Studies” e la risposta ufficiale è stata data dal Dott. Marco Malgarini, il Dirigente Area Ricerca ANVUR, il 19 gennaio 2022.

Revista “Studime Sociale”
klasifikohet si revistë shkencore nga ANVUR

Revista “Studime Sociale” është klasifikuar si revistë shkencore nga ANVUR, Agjencia Kombëtare e Vlerësimit të Sistemit Universitar dhe Kërkimit Shkencor të Italisë - Ministria e Arsimit, Universiteteve dhe Kërkimit Shkencor (MIUR), me vendim no. 298, datë 21 dhjetor 2021.

Aplikimi është bërë në vitin 2022 nga Romina GURASHI (PhD), Universiteti La Sapienza Romë, njëherësh Deputy Editor e revistës “Studime Sociale”.

Nga viti 2020, ANVUR ka monitoruar me ekspertë ndërkombëtarë revistën “Studime Sociale” dhe përgjigja zyrtare është kthyer nga Dott. Marco Malgarini, drejtor i ANVUR, më 19 janar 2022.

SOCIAL STUDIES [STUDIME SOCIALE]

Vol. 20, No. 5 (79), 2026

Editorial Team

Editor-in-Chief:
Leke SOKOLI – Tirana, ALBANIA

Deputy Editors:
Sejdin CEKANI – Tirana, ALBANIA
Besim GOLLOPENI – Pristina, KOSOVO
Ali PAJAZITI – Skopje, NORTH MACEDONIA
Romina GURASHI – Rome, ITALY

Managing Editor:
Elda SOKOLI KUTROLLI

International Editorial Board

Aida GOGA – University of Tirana, ALBANIA
Agri SOKOLI – St. Louis International School Milan, ITALY
Albana CANOLLARI BAZE – Schiller International University, France
Anila HODA – Albanian Academy of Science, ALBANIA
Apostolos G. PAPADOPOULOS – Harokopio University, GREECE
Bavjola SHATRO – University of Mississippi, UNITED STAES OF AMERICA
Enis SULSTAROVA – University of Tirana, ALBANIA
Erenestina GJERGJI HALILI – University of Tirana, ALBANIA
Ervin HOXHAJ – University of Tirana, ALBANIA
Ferdi KAMBERI – University Fehmi Agani of Gjakova, KOSOVO
Goran BASIC – Lund University, SWEDEN
Irena NIKAJ – Universitety Fan Noli of Korca, ALBANIA
Jelena GAKOVIĆ – University of Sarajevo, BOSNIA AND HERZEGOVINA
Jola KEPI – Center for School Leadership CSL-AADF, ALBANIA
Jonida LAMAJ – Albanian American Development Foundation, ALBANIA
Klea FANIKO – University of Geneva, SWITZERLAND
Klejda MULAJ – University of Exeter, ENGLAND
Krešimir ŽAŽAR – University of Zagreb, CROATIA

Kseanela SOTIROFSKI – University Aleksander Moisiu of Durres, ALBANIA
Murat ALIU – Mother Teresa University Skopje, NORTH MACEDONIA
Pjereta AGALLIU – University of Tirana, ALBANIA
Sergiu BALTATESCU – University of Oradea, ROMANIA
Silvana MALACARNE – Catholic University of the Sacred Heart Milan, ITALY
Svetla KOLEVEA – Bulgarian Academy of Science, BULGARIA
Shaban SINANI – Albanian Academy of Science, ALBANIA
Shkëlzen HASANAJ – University of Siena, ITALY
Tonin GJURAJ – University Luigj Gurakuqi Shkoder, ALBANIA
Valbona NATHANAILI – Qiriazi University College, ALBANIA
Venera LLUNJI – AAB College, KOSOVO

© Albanian Institute of Sociology / Instituti Shqiptar i Sociologjisë

Design: **Orest Muça**

"Social Studies", Scientific Journal, certified by the Highest Scientific Committee, Ministry of Education and Science of Albania

Decision no. 170, date 20th of December 2010

Contacts:

Mobile: ++355692044722; ++355694067682

E-Mail: studime.sociale@gmail.com

www.sociology.al

Contents:

Jorida RUSTEMI
Erion KRISTO
Valbona BANKA
AI-Mediated Learning and Children's Development: Knowledge Comprehension and Emotional Recognition Outcomes 5

Ananda RAO KURITI
Intelligent Society for Whom? Power, Inequality, and the Human-Artificial Intelligence (AI) Divide: A Sociological Analysis 23

Blendi LAMI
Albania's International Image through Public Diplomacy 35

Ervin HOXHAJ
Erion SHEHU
A Target in Motion: Reconceptualizing ESP Needs Analysis in the Age of Generative AI 45

Gjovalin GJELOSHI
Luana HARIZAJ
Women in the leadership and establishment of the written albanian press 1848-2024 55

Erjona FUSHA
Zhvillimi i qytetit nën presionin e shoqërisë inteligjente 63

Simon LUFI
Marsel NILAJ
Strategjia e komunizmit kundër besimit katolik në Shqipëri 71

Blerina KARAGJOZI
Zana STRAZIMIRI
Aspekte të ndërgjegjes ekologjike në antikitet 81

Genita HOXHA
Ndërveprimi ndërmjet inteligjencës krijuese njerëzore dhe strukturës muzikore në iso-polifoninë shqiptare. Analizë muzikologjike dhe kulturore e krijimtarisë së Lefter Çipës 93

Migena KAPLLANAJ
Bernard ZENELI
Aktiviteti fizik dhe mirëqenia subjektive e fëmijëve në Shqipëri: roli i privimit material 103

ZHVILLIMI I QYTETIT NËN PRESIONIN E SHOQËRISË INTELIGJENTE

Erjona FUSHA
Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
E-mail: erifusha@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Zhvillimi i shpejtë teknologjik dhe urbanizimi global kanë sjellë transformime të thella në mënyrën se si organizohen dhe funksionojnë qytetet moderne. Koncepti i shoqërisë inteligjente lidhet ngushtë me përdorimin e teknologjive të avancuara, si inteligjenca artificiale dhe analiza e të dhënave, për të përmirësuar cilësinë e jetës urbane. Në këtë punim do të analizohet shoqëria inteligjente nga perspektiva e sociologjisë urbane, duke shqyrtuar ndikimet sociale, ekonomike dhe kulturore të këtij transformimi. Nëpërmjet një qasjeje teorike dhe analitike, punimi eksploron mënyrën se si qytetet inteligjente ndikojnë në marrëdhëniet sociale, strukturat e pushtetit dhe përfshirjen qytetare. Shoqëria inteligjente nuk është vetëm një koncept teknologjik, por edhe një realitet social që përfshin transformime në mënyrën se si njerëzit ndërveprojnë, organizohen dhe marrin pjesë në jetën publike. Në këtë kuadër, sociologjia urbane ofron një perspektivë të rëndësishme për të kuptuar këto ndryshime, duke analizuar ndikimet në strukturat sociale, identitetet urbane dhe marrëdhëniet e pushtetit. Do të analizohet transformimi i qyteteve në epokën e shoqërisë inteligjente, ku teknologjia, digjitalizimi dhe kërkesat e reja sociale ushtrojnë presion të vazhdueshëm mbi planifikimin urban. Zhvillimi urban nuk është më vetëm çështje infrastrukture fizike, por një proces kompleks që ndërthur inovacionin teknologjik, qëndrueshmërinë mjedisore dhe përfshirjen sociale. Nëpërmjet metodave të shqyrtimit të literaturës dhe shembujve të ndryshëm do të trajtohen sfidat kryesore të qyteteve të ditëve të sotme, si dhe mundësitë që ofrojnë qytetet inteligjente për një zhvillim më efikas dhe të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: *qytet, shoqëri inteligjente, urbanizim dhe njeri.*

Dr. **Erjona FUSHA** është pedagoge me kohë të plotë në Kolegjin Universitar Qiriazi, Tiranë. Ajo ka ushtruar detyrën e Drejtueses së Departamentit dhe aktualisht është Drejtuese e Qendrës Kërkimore, pranë Fakultetit të Ekonomisë të këtij universiteti. Është pjesëmarrëse në disa konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, autore artikujsh shkencorë etj.

Hyrje

Shoqëria inteligjente nuk është vetëm një koncept teknologjik, por edhe një realitet social që përfshin transformime në mënyrën se si njerëzit ndërveprojnë, organizohen dhe marrin pjesë në jetën publike. Sociologjia urbane ofron një perspektivë të rëndësishme për të kuptuar këto ndryshime, duke analizuar ndikimet në strukturat sociale, identitetet urbane dhe marrëdhëniet e pushtetit. Urbanizimi është një nga dukuritë më të rëndësishme të shekullit XXI. Sipas të dhënave ndërkombëtare, më shumë se gjysma e popullsisë së botës jeton në zona urbane, dhe ky numër pritet të rritet ndjeshëm në dekadat e ardhshme. Paralelisht me këtë zhvillim, teknologjia ka depërtuar në çdo aspekt të jetës urbane, duke krijuar atë që njihet si "qyteti inteligjent". Shoqëria inteligjente mund të përkufizohet si një formë e organizimit shoqëror ku teknologjia përdoret për të rritur funksionimin e sistemeve urbane dhe për të përmirësuar mirëqenien e qytetarëve. Ky koncept lidhet ngushtë me qytetet inteligjente, të cilat përdorin teknologji për menaxhimin e trafikut, energjisë, sigurisë dhe shërbimeve publike. Nga një perspektivë sociologjike, shoqëria inteligjente përfshin: rritjen e ndërveprimit digjital ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve, transformimin e hapësirave publike në hapësira hibride (fizike dhe virtuale) dhe ndryshimin e formave të pjesëmarrjes qytetare. Në dekadat e fundit, qytetet janë shndërruar në qendra dinamike të zhvillimit ekonomik dhe social. Kjo shoqëri karakterizohet nga përdorimi intensiv i teknologjisë së informacionit, automatizimit dhe analizës së të dhënave për të përmirësuar cilësinë e jetës. Megjithatë, ky zhvillim sjell edhe presione të mëdha mbi strukturën dhe funksionimin e qyteteve. Në epokën digjitale, përparimet teknologjike kanë çuar në një shoqëri gjithnjë e më të atomizuar ku njerëzit janë më të lidhur në dukje, por ndihen më të izoluar. Atomizimi i shoqërisë është një dukuri e shumanshme me pasoja të mëdha i cili ka prekur dukshëm edhe shoqërinë shqiptare. Joshja e platformave digjitale, puna në distancë ka ndryshuar dinamikën e marrëdhënieve ndërpersonale, duke shkaktuar shqetësime për cilësinë dhe thellësinë e lidhjeve njerëzore. Në analizën që i bën kësaj dukurie, sociologu Zyhdi Dervishi (2011: 300) thekson se "lidhjet miqësore, shoqërore e fisnore janë dobësuar e deri paralizuar nga fuqia e përforcuar gërryese e procesit të atomizimit". Në këtë kontekst, atomizimi i referohet procesit me të cilin njerëzit, pavarësisht se janë virtualisht të lidhur, përjetojnë zbehje të lidhjeve njerëzore dhe dobësim të kapitalit social. Ndjekja e pamëshirshme e individualizmit dhe joshja e ndërveprimeve virtuale kanë sfiduar strukturën e komuniteteve tradicionale, duke çuar në një ndjenjë paradoksale të izolimit dhe shkëputjes mes lidhjeve emocionale.

Aspekte metodogjike

Ku fillon kërkimi? Ndonjëherë kërkimi fillon me një ndjenjë habie, një ndjenjë mahnitje me botën sociale që shoqërohet me një dëshirë të fortë për ta kuptuar dhe shpjeguar atë. Ndonjëherë fillon me një ndjenjë krize, si kur një shoqëri është e tensionuar deri në pikën e thyerjes dhe studiuesit kërkojnë zgjidhje. Ky motivim ka ekzistuar që nga fillimet e shkencës sociale në shekullin e tetëmbëdhjetë. Që atëherë, sfidat e paraqitura nga urbanizimi, industrializimi, konflikti etnik dhe pabarazia gjinore (për të përmendur disa) kanë dhënë shtysën për projekte të

panumërta kërkimore (Bell, Bryman & Kleinknecht, 2024: 73). Pra studimi dhe kërkimi në shkencat sociale fillon mbi një dukuri e cila shfaq kuriozitet. Ashtu si për ditët e sotme është me interes kuptimi dhe thellimi në çështjet e ndikimit të teknologjisë dhe shoqërisë inteligjente në zhvillimet e qytetit dhe marrëdhënieve njerëzore në veçanti. Metodologjia e kërkimit orienton rrugëtimin që do të ndjekë studimi për t'iu përgjigjur pyetjeve të ngritura dhe përcakton mjetet e nevojshme për realizimin e kërkimit (Robson, 2002: 76).

Në rrjedhën e zhvillimit të mendimit sociologjik kanë evoluar edhe parapëlqimet për metodat kërkimore. Shumica e sociologëve në shekullin XIX bazoheshin me përparësi në studimet e librave dhe të artikujve të botuar në organet e ndryshme të shtypit. Një model tipik i bazuar në metoda të tilla studimi është vepra e Frederik Engelsit "Gjendja e klasës punëtore në Angli", e cila është botuar për herë të parë në vitin 1845. Më pas studimet sociologjike janë bazuar edhe në studime të tjera dytësore si raporte ose relacione të përgatitura nga struktura qeveritare ose shoqata, fondacione etj. (Dervishi, 2024: 74). Qëllimi i këtij punimi është të eksplorojë mënyrën se si qytetet inteligjente ndikojnë në marrëdhëniet sociale. Nëpërmjet një analize cilësore e literaturës sociologjike dhe të dhënave empirike mbi studime dhe raporte mbi zhvillimet e qytetit dhe shoqërisë inteligjente.

Fakte të shumëllojshme provojnë se në rrjedhën e zhvillimit të njerëzimit janë bërë gjithnjë më komplekse marrëdhëniet ndërmjet njerëzve me njëri-tjetrin dhe me natyrën. Një ndihmesë të veçantë, shumë të rëndësishme në njohjen dhe evoluimin e marrëdhënieve të tilla ofrojnë edhe dijet sociologjike. Zhvillimi dhe pasurimi i dijeve të tilla bazohet metodologjikë, të cilët janë perfeksionuar në mënyrë më të shumanshme dhe me ritme më të shpejta veçanërisht pas Luftës së Parë Botërore. Në krahasim me metodat e kërkimit që përdoren në shkencat natyrore si fizika e kimia, elektroteknika e biologjia etj., metodat e kërkimit sociologjik kanë të bëjnë më drejtpërdrejtë me veprimtaritë e mënyrat e jetës së njerëzve, me mendësitë dhe përjetimet e tyre emocionale (Dervishi, 2024: 69-70). Pra në studimet e shkencave sociale në përgjithësi dhe në sociologji në veçanti dukuritë nuk mund të shpjegohen pa zbuluar rolin dhe ndikimin e marrëdhënies njerëzore.

Gjetje të studimit

Përdorim i teknologjisë është shumë i rëndësishëm në zhvillimin e një qyteti modern. Teknologjia e bën qytetin më efikas, më të sigurt dhe më të qëndrueshëm. Me anë sistemeve digjitale, analizës së të dhënave dhe modeleve 3D, përmirësohet planifikimi urban. Teknologjia mundëson menaxhim inteligjent të trafikut, transport më të koordinuar, informacion në kohë reale për qytetarët dhe reduktim të bllokimeve dhe ndotjes. Sipas të dhënave të fundit të ITU-së (Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit), në vitin 2020, interneti u përdor nga 72.2 për qind e popullsisë në Republikën e Shqipërisë. Ky rezultat është nën mesataren e Evropës prej 84.9 për qind. Numri i përdoruesve të internetit po shtohet vazhdimit, me një rritje vjetore prej 3.3 pikë përqindje gjatë tre viteve të fundit. Ndonëse lidhshmëria në rrjete është shtylla qendrore e transformimit digjital, është me rëndësi thelbësore që ky transformim digjital të ketë në qendër njerëzit, për të siguruar jo vetëm që të gjithë anëtarët e shoqërisë të jenë të lidhur digjitalisht, por edhe

që lidhja e tyre të jetë domethënëse dhe efektive dhe t'u mundësojë të kenë akses dhe të gëzojnë plotësisht të gjitha të mirat e një bote digjitale në rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm (UNWomen, 2023).

Bota digjitale dhe raporti gjinor

Teknologjia ka sjellë ndryshime të mëdha në jetën e njerëzve, duke ndikuar në mënyrën se si komunikojmë, mësojmë dhe punojmë. Megjithatë, qasja dhe përdorimi i teknologjisë nuk janë gjithmonë të barabarta për të gjithë. Një nga çështjet më të rëndësishme në shoq1%rinë moderne është raporti gjinor në përdorimin e teknologjisë, i cili tregon dallimet mes grave dhe burrave në aksesin, përdorimin dhe përfitimet që marrin nga mjetet teknologjike. Në shumë vende të botës, burrat kanë më shumë mundësi për të përdorur internetin, kompjuterët dhe pajisjet e tjera digjitale. Kjo pabarazi njihet si hendeku gjinor digjital. Faktorë të ndryshëm, si niveli ekonomik, arsimi, traditat, kultura ndikojnë në krijimin e këtij hendeku. Në disa shoqëri, vajzat dhe gratë kanë më pak mundësi për t'u trajnuar në fushën e teknologjisë ose për të ndjekur karriera të lidhura me të. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është përfaqësimi i grave në profesionet teknologjike. Edhe pse numri i grave që studiojnë dhe punojnë në fushat e teknologjisë është rritur, ato vazhdojnë të jenë më pak të përfaqësuara krahasuar me burrat. Kjo ndikon jo vetëm në mundësitë e tyre profesionale, por edhe në zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve teknologjike, të cilat duhet të reflektojnë nevojat e të gjithë përdoruesve. Dy të tretat e studentëve në arsimin e lartë janë vajza, por numri i vajzave që ndjekin studimet në degë që lidhen me teknologjinë është shumë i ulët. Degët e studimit në arsimin e lartë vazhdojnë të jenë mjaft të ndara sipas gjinive. Pavarësisht nga numri shumë më i madh i vajzave (59.3 për qind) se sa i djemve (4.07 për qind) në arsimin e lartë, janë më të përfaqësuara në degët e shkencave shoqërore se sa në fushat e shkencave natyrore (UNWomen, 2023).

Modeli inteligjent i qytetit të Singaporit

Modeli i zhvillimit të qytetit të Singaporit konsiderohet një nga modelet më të suksesshme të planifikimit urban në botë. Ai bazohet në planifikimin afatgjatë, rol të fortë të shtetit dhe përdorim efikas të tokës. Institucioni kryesor i planifikimit është Urban Redevelopment Authority (URA). Ai harton plane strategjike për 10-50 vitet e ardhshme dhe i përditëson rregullisht për t'iu përshtatur rritjes ekonomike dhe demografike. Teknologjia dhe qyteti inteligjent është një nga shtyllat kryesore të modelit të zhvillimit dhe teknologjia përdoret në pothuajse çdo aspekt të menaxhimit urban. Qeveria e vendit ka nisur të përdorë qytetin inteligjent (Smart Nation), i cili synon të përdorë teknologjinë për të përmirësuar jetën e qytetarëve dhe efikasitetin e shërbimeve publike. Në këtë qytet janë sensorët dhe kamerat që monitorojnë trafikun në kohë reale. Sistemet inteligjente rregullojnë fluksin e automjeteve. Planifikimi urban përdor të dhëna nga inteligjenca artificiale, modele digjitale të qytetit në 3D dhe analiza të të dhënave për të stimuluar ndikimin e projekteve përpara se ato të ndërtohen. Në këtë qytet shumica e procedurave administrative kryhen on-line, si pagesat, marrja e lejeve, dokumentet zyrtare, shërbimet shëndetësore dhe ato arsimore. Teknologjia është një mjet shumë i fuqishëm në zhvillimin e qytetit, por ajo funksionon duke u mbështetur nga një qeverisje e mirë dhe planifikim efektiv. Në

raportet vjetore të zhvillimit të qytetit të cilat janë të publikuara në faqet në internet thuhet që herë pas here organizohen fokus grupe dhe bashkëbisedim mes qytetarëve dhe anëtarëve të organeve drejtuese për të përmirësuar dhe zhvilluar politikat në të mirë të përmirësimit të kushteve të jetesës. Për shembull në shkurt të vitit 2025, u zhvillua një takim mes 165 qytetarësh në moshës 16-35 vjeç me ministrin e zhvillimit kombëtar dhe drejtuesin e institucionit kryesor të planifikimit. Aty u diskutuan problematikat e moshës së re lidhur me strehimin, hapësirat e punë, gjelbërimin dhe trashëgiminë. Ky sesion ofroi një platformë për të rinjtë për të ndarë prioritetet dhe shqetësimet e tyre, duke fituar nj vlerësim më të thellë të sfidave të planifikimit të qytetit dhe parimeve që udhëheqin politikat për përdorimin e tokës (**URA, 2024-5).**

Sfida të së ardhmes

Zhvillimet e shoqërisë inteligjente në jetën urbane do të sjellin sfida të mëdha në të ardhmen si: privatësia e qytetarëve, menaxhimi i të dhënave, siguria kibernetike, zhvillimi i qëndrueshëm dhe problematika të mirëqenies sociale. Gjatë viteve të fundit, si në Republikën e Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj, kemi patur disa raste të publikimit të të dhënave sekrete dhe të fshehta pa dëshirën personale të njerëzve. Një sfidë tjetër drejt së ardhmes është distancimi i madh i njeriut nga natyra për shkak të zhvillimeve urbane dhe atyre teknologjike. Sipas Robert Putnam, teknologjia moderne shtyn njeriun drejt izolimit social dhe larg aktiviteteve kolektive. Teknologjia sipas tij çon gjithnjë e më shumë drejt individualizmit dhe gjerëve private (Putnam, 2000: 283-284). Gjithashtu, një nga idetë më të rëndësishme të tij argumentojnë se teknologjia e argëtimit teknologjik zëvendëson në jetën komunitare. Argëtimi elektronik, veçanërisht televizioni, është parashikuesi më i qëndrueshëm mos angazhimit qytetar (Putnam, R., 2000:228). Teknologjia i bën njerëzit më pak pjesëmarrës në organizata që merren me punë vullnetare, krijon një rënie të besimit social dhe më pak angazhim politik. Sipas autorëve që studiojnë kapitalin social, në epokën digjitale kemi një transformim të marrëdhënieve njerëzore, sepse sipas tyre modernizimi dhe teknologjia kanë dobësuar lidhjet sociale. Teknologjia dhe rrjetet sociale kanë krijuar lidhje të shpejta, por jo të thella, pra marrëdhëniet sociale janë bërë të përkohshme dhe të brishta.

Ndërsa njerëzit përfshihen më shumë në ndërveprime virtuale dhe tërhiqen nga angazhimi tradicional ballë për ballë, lidhjet e komunitetit fillojnë të gërryhen. Rënia e përvojave të përbashkëta dhe aktiviteteve kolektive mund të çojnë në zvogëlimin e ndjenjës së përkatësisë dhe lidhjes me komunitetin lokal. Ndërveprimet sociale bëhen gjithnjë e më trasanksionale, duke i munguar thellësia dhe reciprociteti që karakterizojnë kapitalin e fortë shoqëror. Në librin "Eksplorimi i kufijve të kapitalit social (Claridge , 2022: 21) citohet:

> Kur lidhjet sociale janë të dobëta, individët përjetojnë nivele më të larta të izolimit social dhe mungesës së mbështetjes, gjë që mund të ndikojë negativisht në mirëqenien e tyre. Kapitali i fortë social lidhet me disponueshmërinë e rrjeteve të mbështetjes sociale. Një nga aspektet kryesore të kapitalit social janë kuptimet e përbashkëta që janë thelbësore për ndërveprim dhe shkëmbim.

Urbanizimi dhe përparimi i shpejtë i teknologjisë kanë përkeqësuar problemet mjedisore duke e distancuar njerëzimin nga natyra. Me rritjen e vazhdueshme

të zonave urbane dhe rënien pasuese të natyrës së paprekur, lidhja e njerëzimit me mjedisin është zhdukur pothuajse plotësisht dhe është zëvendësuar nga indiferenca. Kjo është ajo që disa e quajnë "apati mjedisore". Njerëzit janë të vetëdijshëm për problemet mjedisore dhe i dinë hapat që duhet të ndërmarrin për t'i zgjidhur ato. Megjithatë, pavarësisht këtij ndërgjegjësimi, veprimet shpesh dështojnë, pengohen nga vetëkënaqësia, komoditeti dhe prioritetet konkurruese (Baker, 2025).

https://digitalcommons.csumb.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1122&context=writingwaves

Përfundime

Në dekadat e fundit, qytetet janë shndërruar në qendra dinamike të zhvillimit ekonomik dhe social. Kjo shoqëri karakterizohet nga përdorimi intensiv i teknologjisë së informacionit, automatizimit dhe analizës së të dhënave për të përmirësuar cilësinë e jetës. Në shumë vende të botës, burrat kanë më shumë mundësi për të përdorur internetin, kompjuterët dhe pajisjet e tjera digjitale. Kjo pabarazi njihet si hendeku gjinor digjital. Faktorë të ndryshëm, si niveli ekonomik, arsimi, traditat, kultura ndikojnë në krijimin e këtij hendeku.

Rënia e kapitalit social në një shoqëri të atomizuar mbart pasoja të gjera, si: dobësimi i lidhjeve me komunitetin, gërryerja e besimit social, rritja e vetmisë, pakësim i mbështetjes sociale dhe sfidat për kohezion social janë ndër elementët më negativë.

Zhvillimet e shoqërisë inteligjente në jetën urbane do të sjellin sfida të mëdha në të ardhmen si: privatësia e qytetarëve, menaxhimi i të dhënave, siguria kibernetike, zhvillimi i qëndrueshëm dhe problematika të mirëqenies sociale.

Urbanizimi dhe përparimi i shpejtë i teknologjisë kanë përkeqësuar problemet mjedisore duke e distancuar njerëzimin nga natyra.

REFERENCAT

Baker, Avalon. 2025. "Urbanisation and Technology", Writing Waves, Vol. 6, Article 11, available in https://digitalcommons.csumb.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1122&context=writingwaves (cituar më 16.042026).

Bell, Edward; Bryman, Alan, & Kleinknecht Steven. 2024. *Metodat kërkimit social*, Tiranë: Mediaprint.

Claridge, Tristan. 2022. *Exploring the limits of social capital,* Brisbane, Australia: Institute for Social Capital.

Dervishi, Zyhdi. 2011. *Gratë në turbulencat e mendësive politike dhe realiteti politik*, Tiranë: Emal.

Dervishi, Zyhdi. 2024. *Sociologji*, Tiranë: Emal.

Putnam, Robert. 2000. *Bowling Alone: The Collapse and Revival of American Community*, New York: Simon & Schuster.

Robson, Colin. 2002. *Real World Research*, (2nd edition), MA: Black Well Publishing.

UNWoman Albania. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/202310/digjitalizimi_dhe_tik_web_08102023.pdf

Urban Redevelopment Authority, URA. 2024-5. "Annual Report 2024/2025", https://www.ura.gov.sg/-/media/Corporate/Resources/Publications/Annual-Reports/PDFs/AnnualReport-2024-2025.pdf.